EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5719
E enjte, 7 mars 2019
çmimi 0.40 €

Malta mbështet anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare

FAQE 6

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR 'EPOKËN E RE', RAMADAN QEHAJA

FAQE 4-5

ANËTARËSIMIT NË INTERPOL DUHET T'I QASEMI SERIOZISHT

Njohësi i çështjeve të sigurisë, gjenerali Ramadan Qehaja, ka mirëpritur aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Interpol. Ai ka thënë se, pavarësisht prej disfatave të së kaluarës, Kosova nuk mund të heqë dorë nga përpjekjet për t'u bërë pjesë e kësaj organizate të rëndësishme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Qehaja ka vlerësuar se gjasat për anëtarësim këtë vit duhet të jenë më të mëdha për Kosovën. Ai u ka bërë thirrje institucioneve shtetërore që t'i qasen seriozisht procesit të anëtarësimit në Interpol. Qehaja ka thënë se, pavarësisht prej ndasive politike, spektri politik duhet të veprojë si një trup i përbashkët sa i përket anëtarësimit në Interpol

BEKIM JASHARI: 'EPOPEJA E UÇK-së' PO SHËNOHET NË MËNYRË MADHËSHTORE

Për nder të 21-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së", liderët institucionalë kanë bërë homazhe të mërkurën në Kompleksin Memorial në Prekaz. Me këtë rast, ata kanë vlerësuar se janë të rralla rastet kur një individ dhe një ngjarje ndryshon gjithë historinë e një kombi. Kurse kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, nip i komandantit Adem Jashari, ka thënë se "Epopeja e UÇK-së" po shënohet në mënyrë madhështore



Qosja: I ftoj pushtetarët në Shqipëri e në Kosovë të mësojnë prej shqiptarëve të Tuzit

FAQE 9

AKTUALE

SHQIPËRI, KRIZA POLITIKE DHE RRUGËT E DALJES PREJ SAJ

F. 11

Prof. Lisen BASHKURTI

LIRIDON ALITI, DOKTOR I NANOSHKENCËS NË KOPENHAGË TË DANIMARKËS

F. 9

KOSOVA PRANOHET NË KOMISIONIN NDËRKOMBËTAR PËR PERSONA TË PAGJETUR

F. 9

EKONOMI

ATK-ja KA INKASUAR 88.4 MILIONË EURO PËR DY MUAJ

F. 7

KËRKOHET QË PUSHIMI I LEHONISË TË MBULOHET NGA QEVERIA

F. 7

KULTURË

PANDELI SOTIRI, MËSUESI I PARË I SHKOLLËS SHQIPE

F. 11

Prof. Dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

SPORT

NË KOSOVË DO TË FORMOHET FEDERATA E RAGBIT

F. 13

PRISHTINA DHE FERONIKELI NDAHET NË 'PAQE'

F. 13

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Gjeloshaj: Shqiptarët e Tuzit rikthyen vetëbesimin dhe shpresën

PODGORICË, 6 MARS - Kryetari i sapozgjedhur i Komunës së Tuzit, Nik Gjeloshaj, ka thënë se shqiptarët në Tuz kanë rikthyer vetëbesimin dhe shpresën për të ardhmen në trojet e veta dhe, njëkohësisht, kanë fituar mbështetjen e opinionit më të gjerë mbarëshqiptar për ruajtjen e vlerave të shenjta kombëtare. "Ne u angazhuam me përkushtim që pasi fituam komunën e plotë, të administrojmë vetë të mirat që disponojmë dhe bashkërisht me qytetarët e Tuzit dhe të Malësisë, të ndërtojmë një të ardhme më të mirë dhe më premtuese, sidomos për brezat e rinj. Të gjendur përball kësaj sfide, vepruam në drejtim të unifikimit të spektrit politik shqiptar në këto hapësira. Iniciuam bisedimet dhe ia arritëm që t'i bashkojmë forcat, të bindur se ky është rrugëtimi më i sigurt drejt fitores së shumëpritur", ka thënë Gjeloshaj.

I pari i komunës së Tuzit ka folur edhe për sfidat që e presin në të ardhmen. "Vullneti i dëshmuar në zgjedhjet lokale, dëshira për të instaluar një pushtet shqiptar në krye të komunës, të bindur se kjo duhet të jetë e ardhmja jonë, janë sfidat që duhen përballur por, edhe për t'i realizuar pikësynimet tona programore. Aq më parë pasi përgjegjësia bie mbi ne, sepse ne ishim ata që iu qasëm punës me përkushtimin më të madh për sensibilizimin e opinionit shqiptar, jo vetëm në trevën e Tuzit dhe të Malësisë",

Scaparrotti: Situata e sigurisë në Ballkan është shumë e brishtë

Komandanti i forcave të ShBA-së në Evropë, Curtis M. Scaparrotti, gjatë një dëshmie në Senatin amerikan, ka thënë se vendet e Ballkanit janë shënjestra kryesore të ndikimit malinj të Rusisë e cila kundërshton njohjen e Kosovës si shtet sovran, ndërkaq përmes ndihmës politike, ushtarake dhe ekonomike mundohet ta ruajë ndikimin në Serbi

UASHINGTON, 6 MARS - Situata e sigurisë në Ballkan është shumë e brishtë dhe vendet e Ballkanit janë shënjestra kryesore të ndikimit malinj të Rusisë, ka thënë komandanti i forcave të ShBA-së në Evropë, Curtis M. Scaparrotti, gjatë një dëshmie para Komitetit për Forca të Armatosura të Senatit amerikan.

Scaparrotti, i cili gjithashtu është komandant Suprem i NATO-s në Evropë, e ka quajtur Ballkanin një rajon me rëndësi strategjike përderisa ka folur para senatorëve edhe për bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Negociatat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e raporteve dhe arritjen e një zgjidhje afatgjatë që është e zbatueshme për të dyja vendet janë aktualisht në pritje. Rusia e ushqen paqëndrueshmërinë rajonale në

përpjekje për t'i parandaluar vendet e Ballkanit për përparimin e tyre drejt integrimit euroatlantik" ka thënë gjeneral Scaparrotti, duke nënvizuar faktin se Rusia e kundërshton njohjen e Kosovës si shtet sovran, ndërkaq përmes ndihmës politike, ushtarake dhe ekonomike mundohet ta ruajë ndikimin në Serbi. "Forca e NATO-s në Kosovë (KFOR), e cila përfshin mbi 3 500 trupa nga vendet anëtare të NATO-s dhe vendet e tjera, luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në këtë rajon" ka thënë Scaparrotti, ka njoftuar "rfe". Ai ka folur edhe për gjendjen në Bosnjë e Hercegovinë, duke theksuar se vendi po vazhdon të punojë drejt paqes dhe stabilitetit afatgjatë, pavarësisht prej sfidave nga Republika Serbe e cila është e ndikuar nga Rusia.

Në dëshminë e tij para komitetit për Forca të Armatosura, gjenerali amerikan ka thënë se Rusia është konkurrente afatgjate strategjike që i sheh Shtetet e Bashkuara dhe Aleancën e NATO-s si kërcënime kryesore për ambiciet e saj gjeopolitike. "Moska synon ta shtrijë ndikimin në vendet periferike të saj, për ta minuar solidaritetin e NATO-s dhe për t'i shkelur rregullat në të cilat bazohet rendi ndërkombëtar" ka thënë gjenerali amerikan Scaparrotti.

Blerim Reka i bindur se do të fitojë në zgjedhjet presidenciale

SHKUP, 6 MARS - Kandidati shqiptar për president të Maqedonisë së Veriut, Blerim Reka, të mërkurën ka mbajtur konferencë të përbashkët për medie me kryetarët e Lëvizjes Besa dhe Aleancës për Shqiptarët, Bilall Kasami dhe Ziadin Sela. Ai i falënderoi qytetarët të cilët kanë dhënë nënshkrimet e nevojshme për ta zyrtarizuar kandidaturën e tij dhe u shpreh i bindur se në zgjedhjet presidenciale do të korrin fitore. "Falënderoj të gjithë qytetarët të cilët shprehën gatishmërinë për ta mbështetur kandidaturën për zgjedhjet presidenciale. Gjithashtu e shprehim të mbyllur procesin e mbledhjes së nënshkrimeve. Ky proces me qytetarët do të vazhdojë edhe më tej dhe më 21 prill do të fitojmë së bashku. Maqedonia është shtet, por nuk është republikë", tha Reka. "Republika bëhet me sundim të ligjit. Ajo nuk njeh gjyqësor të politizuar dhe administratë të nepotizuar. Gjatë viteve të kaluara shteti ka qenë pronë e presidentit. Shpresoj që së bashku do ta arrijmë qëllimin dhe ta shohim Maqedoninë në BE", tha Reka.

Ndërsa kryetari i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, tha se koncepti i kandidatit Blerim Reka është i qartë dhe se të gjitha partitë duhet të rreshtohen në mbështetje të tij.

Zgjedhjet presidenciale do të mbahen më 21 prill ndërsa, përveç Blerim Rekës, për kryetar shteti do të garojnë edhe Stevo Pendarovski si kandidati konsensual i partive në pushtet dhe Gordana Siljanovska nga opozita maqedonase.

Vuçiq: Serbia nuk hyn në BE pa marrëveshje me Kosovën

BEOGRAD, 6 SHKURT - Serbia nuk mund të hyjë në BE derisa të mos arrijë një marrëveshje me Prishtinën, tha të mërkurën presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiqi, duke shtuar se ka ardhur koha për t'i ndaluar "të dërguarit e rremë serbë" që thonë se në BE munden edhe pa zgjidhur problemin e Kosovës. Ai këto komente i bëri pas takimit me kryeministrin e Italisë, Guissepe Conte, në Beograd, ku nuk ka munguar tema e Kosovës. Vuçiqi paralajmëroi se pa një marrëveshje me Prishtinën nuk ka anëtarësim në BE as për Serbinë dhe as përparim në këtë drejtim për Kosovën.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kanë vazhduar manifestimet për nder të "Epopesë së UÇK-së"

Bekim Jashari: 'Epopeja e UÇK-së' po shënohet në mënyrë madhështore

Për nder të 21-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së", liderët institucionalë kanë bërë homazhe të mërkurën në Kompleksin Memorial në Prekaz. Me këtë rast, ata kanë vlerësuar se janë të rralla rastet kur një individ dhe një ngjarje ndryshon gjithë historinë e një kombi. Kurse, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, nip i komandantit Adem Jashari, ka thënë se "Epopeja e UÇK-së" po shënohet në mënyrë madhështore

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 MARS - Kanë vazhduar aktivitetet edhe gjatë së mërkurës për nder të 21-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së". Liderët institucionalë kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial në Prekaz, duke e vlerësuar lart sakrificën e familjes Jashari.

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se "Epopeja e UÇK-së", në nderim të veprës dhe sakrificës sublime të komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, familjes Jashari dhe të rënëve të tjerë të lagjes, po shënohet në mënyrë madhështore. "Rënia e Adem Jasharit, për lirinë e vendit tonë, na obligon të jemi të bashkuar si kurrë më parë dhe ta avancojmë ndërtimin e Kosovës, ku pasardhësit tanë të jetojnë në të mira e begati. Lavdi e përjetshme sakrificës së Adem Jasharit, familjes së tij, dëshmorëve të kombit, martirëve dhe gjithë të rënëve të tjerë për lirinë e Kosovës", ka shkruar kryetari Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar nga kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka vendosur lule në Kompleksin Memorial në Prekaz, duke thënë se në raste të tilla si ky, kur një individ dhe një ngjarje ndryshon gjithë historinë e një kombi, janë të rralla në historinë e popujve. Ai ka thënë se Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila, me komandantin legjendar Adem Jashari, me luftën, qëndresën dhe sakrificën e tij, ndryshoi rrjedhat e zhvillimeve të gjithëmbarshme të kombit tonë, është rasti më unik në historinë botërore. "Sot ne jemi krenarë dhe ecim bashkërisht përpara në rrugën e forcimit të shtetit e të integrimit euro-atlantik. Askush nuk mund të na dalë përpara dhe askujt nuk i frikësohemi. Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Ajo do të jetë më e zhvilluar, më e fuqishme dhe më sovrane edhe për faktin se ka orientim të qartë të partneritetit me ShBA-në dhe BE-në. Po ashtu, ka orientim të qartë edhe sa i përket zhvillimit të vet të gjithëmbarshëm, por edhe të fqinjësisë së mirë me fqinjët e saj", ka theksuar kryeparlamentari Veseli.

Ai ka deklaruar se ata që duan fqinjësi të mirë do ta kenë atë, ndërsa ata që nuk e respektojnë shtetin e Kosovës po ashtu do të përballen me të njëjtën qasje. "Jam këtu, së bashku me kryetarin e Komunës së Skenderajt, i cili është pjesë e kësaj lavdie, e kësaj sakrifice dhe e këtij kontributi. Nuk ka gjë më të mirë sesa dy dekada pas kësaj rënieje heroike, në Kosovën, në Drenicën dhe në Skenderajn e lirë, ta kemi kryetar komune pikërisht nipin e komandantit legjendar Adem Jashari. Lavdi dhe respekt të gjithë atyre që kanë sakrifikuar dhe familjeve të tyre!", është shprehur Veseli.

Me rastin e bërjes homazhe në kompleks, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se historisë së Kosovës së lirë dhe të pavarur i dha vulë sakrifica sublime e familjes Jashari dhe komandantit legjendar Adem Jashari. "21 vjet më parë vendi dhe bota përjetoi tragjedinë më të madhe, një familje e tërë u flijua duke mbrojtur tokën tonë, duke mbrojtur të drejtën tonë. Sot përpara varreve në Prekaz, përulemi përjetësisht para veprës së familjes Jashari dhe gjithë brezave që u flijuan për liri. I përhershëm do të jetë kujtimi për familjen Jashari dhe ideatorin e lirisë dhe shtetit të Kosovës, komandantit Adem Jashari", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".

Ndërsa kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se sot shqiptarët kudo që janë vijnë në Prekaz në këtë ditë të shenjtë për të nderuar dhe shprehur respektin dhe përuljen para një personaliteti të madh, i cili i ndryshoi rrjedhat e historisë. "Ardhja në Prekaz duhet të shërbejë për të gjithë ne për të kujtuar se atë që sot ne e kemi dhe e gëzojmë është rezultat i një sakrifice biblike, të panjohur në këtë pjesë të Evropës. Nga një familje e madhe dhe nga një drejtues i madh i luftës çlirimtare siç është komandanti legjendar dhe si detyrë që ne të tjerët të gjallët ta vazhdojmë rrugën drejt realizimit të objektivave tona për të pasur një Kosovë të fuqishme, të lirë, një mirëqenie dhe demokratike", ka thënë Limaj.

Homazhe në Kompleksin Memorial në Prekaz kanë bërë edhe ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, edhe shumë qytetarë nga të gjitha trojet shqiptare.

Kuvendi mbajti seancë të veçantë për nder të "Epopesë së UÇK-së"

PRISHTINË, 6 MARS - Kuvendi i Republikës së Kosovës, me rastin e shënimit të 21-vjetorit të "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", mbajti të mërkurën seancë të veçantë. Fillimisht, fjalën e mori kryeministri Ramush Haradinaj, i cili tha se sot po përkujtojnë me respekt sakrificën sublime të komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij. "Në Prekaz, falë sakrificës supreme dhe të paarritshme për liri të Jasharëve, ka ndodhur kthesa historike. Sakrificë e paarritshme në madhështinë e saj, që ia rriti zërin thirrjes së shqiptarit të shkelur në përmasa botërore. Jasharët dhanë krejt çka kishin të tyren për ne dhe për atë që është e jona. Adem Jashari ishte zemra e orës shqiptare që lëvizi përpara akrepat e historisë, duke ndryshuar epokat", ka thënë Haradinaj.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se sakrifica e familjes Jashari ndryshoi historinë e kombit tonë. "Janë disa ngjarje që bartin peshën e ndërrimit të epokave. Ato shënojnë ndarjen e së tashmes prej së shkuarës, duke hapur shtigje të reja nëpër të cilat ecin popujt dhe shtetet. Një peshë të tillë e ka 5 marsi i vitit 1998. Atë ditë në Prekaz po ndryshonte historia e kombit tonë. Kosova po niste rrugën e pakthim drejt lirisë dhe, pa dyshim, simboli më unik i kësaj rruge ishte Adem Jashari dhe familja e tij martire", ka

thënë ai, duke shtuar se lufta dhe rënia e tyre, sakrifica e tyre e pashembullt në historinë njerëzore, e vulosën përcaktimin e popullit tonë për liri.

Flet për "Epokën e re", Ramadan Qehaja

Anëtarësimit në Interpol d

Njohësi i çështjeve të sigurisë, gjenerali Ramadan Qehaja, ka mirëpritur aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Interpol. Ai ka thënë se, pavarësisht prej disfatave të së kaluarës, Kosova nuk mund të heqë dorë nga përpjekjet për t'u bërë pjesë e kësaj organizate të rëndësishme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Qehaja ka vlerësuar se gjasat për anëtarësim këtë vit duhet të jenë më të mëdha për Kosovën. Ai u ka bërë thirrje institucioneve shtetërore që t'i qasen seriozisht procesit të anëtarësimit në Interpol. Qehaja ka thënë se, pavarësisht prej ndasive politike, spektri politik duhet të veprojë si një trup i përbashkët sa i përket anëtarësimit në Interpol

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

Prishtinë, 6 mars - Eksperti i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka thënë të martën se Kosova ka bërë mirë që edhe këtë vit ka aplikuar për anëtarësim në Interpol. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se institucionet shtetërore duhet t'i qasen seriozisht procesit të anëtarësimit në Interpol. "Gjasat për anëtarësim në këtë vit duhet të jenë më të mëdha për arsye se tash i dimë metodat e veprimit të kundërshtarit, edhe pse kundërshtari është shumë i fuqishëm. Por, duhet të punojmë fuqishëm dhe duhet të përgatitemi për t'u ballafaquar me pengesat e Serbisë në këtë proces. Duhet t'i qasem seriozisht anëtarësimit në Interpol me njerëz seriozë dhe të përgatitur, por jo të merren njerëz që nuk kanë ndikim dhe nuk kanë kapacitete për të lobuar. Qysh tani duhet t'i kërkojmë njerëzit me përgatitjet e duhura", është shprehur Qehaja.

Pavarësisht prej ndasive politike, ai ka thënë se spektri politik duhet të veprojë si një trup i përbashkët sa i përket anëtarësimit në Interpol. "Kemi shumë probleme të brendshme politike dhe se si do të rrjedhin gjërat unë nuk mund të parashikoj, por momentalisht nuk jemi në situatë shumë të favorshme. Mirëpo, pavarësisht prej kësaj, çështjen e Interpolit duhet veçuar që tani. Domethënë, pavarësisht prej këtyre çështjeve të brendshme të cilat po na ndajnë, ne duhet të veprojmë si një trup i përbashkët sa i përket anëtarësimit në Interpol. Pra, me një plan të menduar dhe detajuar mirë, me njerëz të zgjedhur në Kosovë edhe në diasporë të cilëve duhet t'u mbahen kurset e duhura dhe të punojmë fuqishëm në këtë drejtim. Pavarësisht prej ngjarjeve, se a do të ketë apo jo zgjedhje të parakohshme, çështja e Interpolit duhet të ecë tutje", ka deklaruar Qehaja. Po ashtu, ai ka thënë se për të pasur sukses për anëtarësim në Interpol politikisht duhet të punohet shumë me diplomacinë e shteteve mike të Kosovës.

"Epoka e re": *Z. Qehaja, Kosova edhe këtë vit ka aplikuar për anëtarësim në organizatën ndërkombëtare të policisë Interpol. Si e komentoni këtë vendim dhe a mendoni se është hap i qëlluar?*

Qehaja: Është bërë mirë që Kosova ka aplikuar përsëri për t'u anëtarësuar në Interpol. Kosova nuk mund të heqë dorë nga përpjekjet për t'u bërë pjesë e kësaj organizate të rëndësishme pavarësisht prej deklarimeve se këtë vit nuk është dashur të aplikohet. Duke e ditur rëndësinë e kësaj organizate policore ndërkombëtare, mendoj se është bërë mirë që Kosova ka qenë këmbëngulëse që në tetor të këtij viti përsëri të tentojë të anëtarësohet në Interpol. Vitin e kaluar kemi pasur mjaft njerëz të implikuar në këtë proces për të lobuar për anëtarësimin e Kosovës në Interpol, por ata nuk kanë qenë të parapërgatitur. Pra, një numër i tyre nuk kanë qenë edhe aq të përgatitur si t'i qasen kësaj çështje dhe si t'i bindin shtetet që kanë qenë kundër Kosovës. Numerikisht kemi pasur mjaft njerëz të angazhuar, por efekti nuk ka qenë i duhur. Në bazë të asaj çka ka ndodhur vitin e kaluar, pra duke e pasur parasysh agresivitetin e treguar nga Serbia kundër anëtarësimit të Kosovës në Interpol dhe metodat e përdorura, duhet të orientohemi dhe t'i kundërvihemi asaj propagande dhe atyre veprimeve të Serbisë. Tash e kemi numrin e shteteve të cilat kanë qenë të rezervuara dhe të cilat nuk na kanë votuar, prandaj prej sot e tutje duhet të orientohemi tek ato shtete në drejtim të përgatitjeve për anëtarësim sepse koha po kalon dhe shumë shpejt do të vijë tetori kur edhe do të vihet në rend të ditës kërkesa e Kosovës për anëtarësim në Interpol në mënyrë që të mos ndodhë të dështojmë edhe kësaj here.

"Epoka e re"*: Si e shihni ecurinë e këtij procesi pikërisht duke e pasur parasysh rolin destruktiv të Serbisë?*

Qehaja: Serbia ka bërë çmos me një propagandë të tmerrshme kundër anëtarësimit të Kosovës dhe ia ka arritur qëllimit. Nuk dua të flas për metodat të cilat i kanë përdorur. Por, në bazë të asaj që ajo ka bërë, Kosova duhet të orientohet dhe ta bëjë përgatitjen e njerëzve që do të angazhohen këtë vit në këtë proces. Duhet

uhet t'i qasemi seriozisht

të përzgjedhen njerëz të përgatitur të cilët dinë të flasin dhe të lobojnë. Duhet t'i përgatisim këta njerëz në mënyrë që të na garantojnë sukses. Nëse ka nevojë duhet të ndahen edhe mjete financiare për t'i gjetur njerëzit me të cilët duhet biseduar dhe që kanë influencë në shtetet përkatëse. Kështu që duhet të bëhet një plan paraprak dhe jo të shkohet pa plan. Edhe vitin e kaluar ka pasur plan por, megjithatë, nuk ka qenë i mirëfilltë dhe nuk është realizuar ashtu siç është menduar.

"Epoka e re": *Çfarë duhet të ndryshohet saktësisht për të pasur sukses?*
Qehaja: Për t'u bërë pjesë e Interpolit fillimisht duhet të përzgjedhen njerëzit që na përfaqësojnë, të cilët e dinë këtë problematik. Në mesin e Policisë së Kosovës ka njerëz të aftë të cilët mund të lobojnë, edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme mund të ketë, por kapacitet e kësaj ministrie nuk janë edhe aq të mëdha. Në suaza të Kosovës duhet t'i kërkojmë njerëzit nga lëmenj të ndryshëm të cilët mund të kontribuojnë në këtë drejtim dhe të hartohet plani dhe të fillohet përgatitja e tyre kush ku do të veprojë dhe si do të veprojë. Domethënë, pa konkretizimin e gjërave nuk mund të ecim përpara sepse mund të ndodhë që përsëri të dështojmë. Mendoj se Serbia, përveç metodave që i ka përdorur më herët, do t'i përdorë edhe metodat e tjera, pra do të zbulojë diçka kundër Kosovës dhe ne duhet t'i angazhojmë të gjitha segmentet e sigurisë në mënyrë që të dimë se si do të veprojnë ata dhe si do të mund t'u kundërvihemi.

"Epoka e re": *Pra, mendoni se Kosova këtë herë duhet ta ndryshojë qasjen dhe të jetë më e përgatitur në mënyrë që të anëtarësohet përfundimisht në Interpol?*
Qehaja: Këtu e kemi një të metë sepse po i shihni rrjedhat politike në vend të cilat nuk janë të volitshme. Kemi shumë probleme të brendshme politike. Se si do të rrjedhin gjërat unë nuk mund të parashikoj, por momentalisht nuk jemi në situatë shumë të favorshme. Mirëpo, pavarësisht prej kësaj, çështjen e Interpolit duhet veçuar që tani. Domethënë, pavarësisht prej këtyre çështjeve të brendshme të cilat po na ndajnë, ne duhet të veprojmë si një trup i përbashkët sa i përket anëtarësimit në Interpol. Pra, me një plan të menduar dhe detajuar mirë, me njerëz të zgjedhur në Kosovë dhe në diasporë, të cilëve duhet t'u mbahen kurset e duhura dhe të punojmë fuqishëm në këtë drejtim. Pavarësisht prej ngjarjeve, se a do të ketë apo jo zgjedhje të parakohshme, çështja e Interpolit duhet të ecë tutje.

"Epoka e re": *Jeni optimist se këtë vit gjasat do të jenë më të mira për anëtarësim?*
Qehaja: Gjasat për anëtarësim në këtë vit duhet të jenë më të mëdha për arsye se tash i dimë metodat e veprimit të kundërshtarit, edhe pse kundërshtari është shumë i fuqishëm. Serbia pjesën më të madhe të diplomacisë së ish-Jugosllavisë e ka përvetësuar dhe logjistikën e asaj diplomacie është duke e përdorur, prandaj nuk është e lehtë kjo punë. Por, duhet të punojmë fuqishëm dhe duhet të përgatitemi për t'u ballafaquar me pengesat e Serbisë në këtë proces. Duhet t'i qasem seriozisht anëtarësimit në Interpol me njerëz seriozë dhe të përgatitur. Por, jo të merren njerëz që nuk kanë ndikim dhe nuk kanë kapacitete për të lobuar. Në të kaluarën ka pasur raste që disa njerëz kanë pasur probleme edhe me gjuhën angleze e lërë më me gjuhën e shtetit përkatës. Qysh tani duhet t'i kërkojmë njerëzit me përgatitjet e duhura.

"Epoka e re": *Në këtë proces, a do të ketë ndikim edhe dialogu Kosovë - Serbi?*
Qehaja: Gjithsesi se do të ketë. Ndasitë dhe vështirësitë tona që kanë të bëjnë me Serbinë zyrtare dhe me dialogun ndërlidhen edhe me çështjen e anëtarësimit në Interpol. Por, pavarësisht prej kësaj, në bisedimet e ardhshme me Serbinë duhet t'ia bëjmë të qartë që ta ndërpresë propagandën e egër ndaj Kosovës sa i përket anëtarësimit në Interpol sepse kjo është organizatë shumë e fuqishme dhe e rëndësishme në aspektin e sigurisë. Nëse Serbia nuk është e interesuar që siguria rajonale dhe evropiane të jetë në nivel është problem i saj, por këtë duhet t'ia themi troç. Duhet të jemi shumë të vëmendshëm për shpjegimin e gjërave edhe në tavolinë të bisedimeve nëse kjo çështje shtrohet apo në kuluaret e ndryshme atje. Politikisht duhet të punohet shumë me Serbinë zyrtare, me diplomacinë tonë dhe me diplomacinë e shteteve mike të Kosovës në mënyrë që të kemi më të vërtetë sukses në këtë vit dhe të bëhemi pjesë e Interpolit.

Kosova pranohet në Komisionin Ndërkombëtar për Persona të Pagjetur

Prishtinë, 6 mars (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me drejtoreshën e përgjithshme të Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Pagjetur, Ketrin Bomberger. Po të mërkurën Kosova është anëtarësuar në këtë organizatë që trajton çështjen e personave të zhdukur. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje tashmë po marrin obligime të ndërsjella që trajtojnë zbardhjen e fatit të personave ende të pagjetur. "Jemi sot me kryesuesen e ICMP-së, pra Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Pagjetur. Kosova që nga sot i ka dhënë akreditim Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Pagjetur. Tash po e nënshkruajmë edhe një marrëveshje, ku marrim obligime të ndërsjella për bashkëpunim, për zbardhjen e kësaj çështjeje që është e jona, e Kosovës, e cila është edhe multilaterale, sepse kjo përfshinë edhe palët e tjera në rajon dhe kësisoj po vazhdon një traditë e punës, që është edhe pjesë e procesit të Berlinit dhe e zhvillimeve të deritashme", ka thënë kryeministri Haradinaj.
Kryeministri Haradinaj i ka falënderuar të gjitha organizatat për personat e pagjetur që janë në Kosovë, po ashtu edhe Komisionin Shtetëror të Kosovës që merret me këtë proces. Ndërkaq, drejtoresha e përgjithshme e Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Pagjetur, Ketrin Bomberger, ka thënë se arritja e kësaj marrëveshjeje shënon një moment tjetër historik. Ajo ka thënë se janë të lumtur që sot e shënojnë këtë rast për të rritur edhe më shumë bashkëpunimin dhe që të ketë edhe një bashkëpunim rajonal për ta adresuar këtë çështje shumë të ndjeshme.
Ndër të tjera, kryeministri Haradinaj ka pohuar se bashkëpunimi me këtë Komision është që nga viti 1999, por që nga sot ky lloj bashkëpunimi është fuqizuar dhe ka kaluar në një nivel tjetër të marrjes së përgjegjësive dhe obligimeve që kanë ndaj personave ende të zhdukur.

Malta mbështet anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare

Ministri i Punëve të Jashtme dhe Promovimit të Tregtisë së Maltës, Carmelo Abela, po qëndron për vizitë në Kosovë. Ai të mërkurën është takuar me ministrin e Jashtëm Behgjet Pacolli, me të cilin ka mbajtur edhe një konferencë për media, me ç'rast ka ofruar përkrahjen e Maltës për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 6 mars - "Republika e Maltës vazhdon të qëndrojë përkrah Kosovës në rrugëtimin tonë evropian, duke qenë ndër shtetet më mbështetëse në BE si për liberalizim të vizave, po ashtu edhe për integrimin e Kosovës në BE. Malta ka qenë dhe vazhdon të jetë e zëshme në mbështetje të Kosovës në çdo organizatë ndërkombëtare dhe është zëri ynë edhe aty, ku ne nuk mund të jemi ende", kështu ka thënë zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, pas takimit që ka zhvilluar në Prishtinë me homologun nga Malta, ministrin e Punëve të Jashtme dhe Promovimit të Tregtisë, Carmelo Abela.

Pacolli ka thënë se dy vendet gëzojnë një partneritet të qëndrueshëm dhe një miqësi të fortë. "Jam i lumtur që sot shkëmbyem Notën zyrtare, për ta vazhduar kornizën e bashkëpunimit në mes të dy MPJ-ve edhe për dy vjet të tjera, për t'i thelluar më tej marrëdhëniet tona përmes konsultimeve politike, shkëmbimit të ekspertizave në integrimin evropian, përmes iniciativave kulturore që dy popujt tanë ta njohin më mirë njëri-tjetrin; trajnimin e diplomatëve të rinj; aktivitete në promovim të investimeve të tregtisë etj", ka thënë Pacolli, duke shtuar se është i lumtur që sot e finalizuan edhe marrëveshjen dypalëshe për eliminimin e taksave të dyfishta. "Kjo marrëveshje do të ndihmojë drejtpërdrejt në hapjen e rrugëve për shkëmbimet tregtare midis Kosovës dhe Maltës dhe Ministria që e udhëheq do ta bëjë të pamundurën për promovimin e shkëmbimeve me bizneset kosovare dhe agjencitë përkatëse shtetërore", ka shtuar numri dy i Qeverisë, Pacolli.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur në takim ministrin e Punëve të Jashtme dhe Promovimit të Tregtisë të Maltës, Carmelo Abela, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike dhe progresin e arritur në Kosovë, prioritetet e Qeverisë për zhvillim ekonomik, integrimet evropiane, si dhe fuqizimin në rend dhe ligj.

Kryeministri Haradinaj me këtë rast ka thënë se Malta është një nga vendet mike të Kosovës, duke zhvilluar gjithmonë raporte korrekte me këtë vend dhe se ky bashkëpunim do të vazhdojë meqenëse Kosova është e përkushtuar t'i avancojë raportet e ndërsjella në të gjitha fushat. "Edhe në të kaluarën ne gjithmonë kemi ruajtur dhe zhvilluar partneritet të mirë me Maltën dhe ky vend e ka mbështetur Kosovën në proceset ndërkombëtare. Sot ishte rast i mirë ta ritheksojmë përkushtimin tonë, që të avancojmë më tutje bashkëpunimin tonë, veçmas në këmbimet tregtare dhe në ato kulturore", u shpreh Haradinaj. Kurse ministri i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë të Maltës, Carmelo Abela, ka thënë se Malta do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në rrugën evropiane dhe në anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare si dhe qëndrimin e shtetit të tij për fuqizimin e partneritetit ekonomik, tregtar dhe kulturor.

Ministrin e Jashtëm të Maltës e ka pritur në takim edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Ministri i Punëve të Jashtme dhe Promovimit të Tregtisë të Maltës, Carmelo Abela, po e viziton Republikën e Kosovës me ftesë të zëvendëskryeministrit të parë dhe ministrit të Jashtëm, Pacolli, ndërsa gjatë qëndrimit disaditorë në vendin tonë, ai do t'i takojë edhe udhëheqësit e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Malta e kishte njohur Republikën e Kosovës disa muaj pas shpalljes së pavarësisë së vendit, ndërsa që nga ajo kohë janë lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi dhe janë shkëmbyer vizita në nivelet më të larta shtetërore.

Apostolova: Arsimi cilësor është krucial për zhvillimin e Kosovës

EPOKA E RE Qendresa RAMA

Prishtinë, 6 mars - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi dhe shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, kanë marrë pjesë të mërkurën në tryezën e organizuar nga Bashkimi Evropian, me temë "Cilësia e arsimit në Kosovë".

Ministri Bytyqi, me këtë rast, ka folur për reformat që po bëhen në të gjitha nivelet e arsimit, në mënyrë që fëmijëve dhe të rinjve t'iu ofrohet edukim dhe arsim cilësor. Bytyqi përmendi fillimisht përgatitjet që po bëhen për të ofruar edukim parashkollor për sa më shumë fëmijë. Në këtë drejtim, ai ka thënë se MAShT-i është në fazën finale të hartimit të kurrikulës për edukimin e hershëm, ndërsa ka përmendur si sfidë gjendjen jo të mirë të infrastrukturës.

Ministri Bytyqi ka theksuar edhe projektin që është duke u përgatitur bashkë me UNICEF-in për moshat 0-3 vjeç, ku do t'u ofrohen prindërve informata për edukimin e hershëm përmes vizitave nëpër familje dhe materiale. Duke folur për arsimin parauniversitar, ministri ka theksuar disa hapa të rëndësishëm që janë duke u ndërmarrë për t'i evituar dobësitë në këtë nivel të arsimit. Bytyqi ka përmendur tekstet e reja që po përgatiten në përputhje me kurrikulën e re dhe me standarde ndërkombëtare. Po ashtu, ministri ka përmendur edhe trajnimet e mësimdhënësve, duke theksuar se tashmë bashkë me partnerët, është marrë vendim që kjo çështje e rëndësishme t'i besohet Fakultetit të Edukimit.

Ndër të tjera, ministri Bytyqi ka folur edhe për ndryshimet që po planifikohen të bëhen në qeverisjen e shkollave, përmes Udhëzimit Administrativ, me të cilin rolin kyç për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave do ta kenë prindërit.

Ministri Bytyqi ka përmendur edhe hapat që janë marrë për ndryshimin e gjendjes në arsimin e lartë dhe, ndër të tjera, ka theksuar hapat që janë marrë që Agjencia e Kosovës për Akreditim të ketë një rol shumë të rëndësishëm për të siguruar cilësi në arsimin e lartë. Ndërkaq shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka thënë se arsimi cilësor është krucial për zhvillimin e vendit. Ajo ka përmendur investimet që janë bërë nga ana e Bashkimit Evropian, ndërsa ka theksuar se, edhe pse ka lëvizje pozitive në arsim, ka nevojë për reforma për ta përmirësuar gjendjen.

KËRKOHET QË PUSHIMI I LEHONISË TË MBULOHET NGA QEVERIA

Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka kërkuar që në Kosovë të rregullohet Ligji i punës për pushimin e lehonisë ashtu siç është në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Kroaci, Gjermani dhe shtete të tjera, ku pushimi i lehonisë mbulohet nga Qeveria

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 MARS - Ligji për pushimin e lehonisë, numri i ulët i femrave të punësuara në Kosovë në raport me rajonin, ripërsëritja e kërkesës ndaj institucioneve, ishte qëllimi i konferencës me media të organizuar nga Oda e Afarizmit të Kosovës.

Koordinatorja e OAK-së, Qëndresa Ibrahimi, ka theksuar se Oda e Afarizmit të Kosovës ka kohë që është duke u marrë me çështjen e pushimit të lehonisë dhe ka përgatitur rekomandimet konkrete drejtuar institucioneve të vendit duke marrë parasysh faktin se kemi një shkallë të ulët të punësimit të femrave, shifër kjo të cilën OAK-u e konsideron alarmuese.

Ndërsa zyrtarja për biznese e OAK-së, Rreze Cana, ka thënë se Pushimi i Lehonisë është një nga politikat që shtetet e përdorin për ta stimuluar natalitetin dhe rritjen e punësimit të femrave ndërsa, sipas saj, në Kosovë po ndodh e kundërta, duke marrë parasysh se Kosova deri vonë është cilësuar populli me shtimin më të lartë të popullsisë në Evropë. "Prandaj është e rëndësishme që vendi të marrë masa për krijimin e një balance mes numrit të lindjeve dhe të mos diskriminohen femrat në punësim", ka thënë Cana. Sipas saj, Kosova vazhdon të jetë vendi me papunësinë më të madhe të femrave në rajon. "Në Kosovë vetëm 12.6 për qind të femrave janë të punësuara. Kjo ndodh për shkak të disa arsyeve. Një prej tyre që po e pengon rritjen e punësimit të femrave është detyrimi i bizneseve që të paguajnë dy paga për një vend pune", ka thënë ajo.

Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka kërkuar që në Kosovë të rregullohet Ligji i punës për pushimin e lehonisë ashtu siç është në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Kroaci, Gjermani dhe shtete të tjera, ku pushimi i lehonisë mbulohet nga Qeveria.

BIZNESET KANADEZE TË INTERESUARA PËR SEKTORIN MINERAR

PRISHTINË, 6 MARS (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, në ditën e dytë dhe të fundit të qëndrimit në Kanada, ka prezantuar potencialet e Kosovës në sektorin minerar dhe sektorë të tjerë para bizneseve të shumta kanadeze.

Ky prezantim zgjoi interesim të jashtëzakonshëm, që u konfirmua menjëherë që një delegacion biznesor nga Kanadaja do të vijë në Kosovë në muajin shtator të këtij viti. Më pas ministri Lluka ka zhvilluar takim shumë produktiv me zëvendësministrin e Energjisë dhe Minierave të Turqisë, Mithat Cans?z, nga i cili është informuar që Qeveria e Turqisë ka themeluar një kompani ku për qëllim ka investimin në kompani minerare në mbarë botën. Ata shprehen interesimin për një vizitë në Kosovë për t'i shikuar potencialet minerare nga afër.

Takimet pastaj vazhduan me kompani kanadeze te zyrat e Konsullatës së Kosovës në Toronto, ku tema kryesore ishte Trepça dhe zonat me interes të veçantë.

Vizita u përmbyll me takimin përfundimtar me bizneset e Shoqatës së Bizneseve të Diasporës së Kosovës në Toronto, ku ministri Lluka ka bashkëbiseduar me ta për potencialet investuese të diasporës, duke u kërkuar mbështetje të mëtutjeshme përmes hapjes së bizneseve në Kosovë të cilat do të gjeneronin vende të reja të punës.

ATK-ja ka inkasuar 88.4 milionë euro për dy muaj

PRISHTINË, 6 MARS - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) për dy muajt e parë të këtij viti ka arritur të ketë performancë të mirë sa i përket inkasimit të të hyrave. Përgjatë kësaj periudhe janar-shkurt 2019 janë mbledhur 88.4 milionë euro. Nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë mbledhur 12 për qind apo 9.5 milionë euro më shumë. "Rezultat për rritjen e të hyrave janë avancimi i shërbimeve ndaj tatimpaguesve, të cilat kanë lehtësuar në masë të madhe deklarimin dhe pagesën e tatimeve, si dhe kanë ngritur nivelin e përmbushjes vullnetare. Po ashtu, këtu rol të rëndësishme ka edhe rritja e aktiviteteve në terren, e sidomos ndërmarrja e veprimeve për mbledhjen e borxheve tatimore, të cilat aktivitete do të shtohen edhe më shumë ditët në vijim", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Në këtë njoftim theksohet se ATK-ja do të vazhdojë të punojë për ruajtjen dhe ngritjen e imazhit të një administrate transparente dhe në shërbim të të gjithë tatimpaguesve. "Motoja e përgjithshme e punës sonë qëndron në krijimin e një mjedisi, i cili mbështet fuqimisht përmbushjen e detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve dhe, mbi të gjitha, trajtim i barabartë për të gjithë tatimpaguesit në mënyrë që secili ta paguajë pjesën që i takon me ligj", është theksuar në njoftimin e ATK-së.

A. MAVRAJ

SHQIPËRI, KRIZA POLITIKE DHE RRUGËT E DALJES PREJ SAJ

Lisen BASHKURTI

Shqipëria ka hyrë në një krizë politike, që ngjan me një tunel pa dalje. Pas viteve '90 ne vijojmë të prodhojmë kriza politike të brendshme, të cilat nuk i zgjidhim dot vetë, pra pa ndërhyrjen e huaj. Kemi afro 30 vjet që jemi prodhues krizash politike, pa mundur të krijojmë kapacitete për menaxhimin dhe zgjidhjen e tyre. Në fakt, krizat i bashkëshoqërojnë shoqëritë njerëzore, përshirë edhe shoqëritë demokratike. Dallimi midis shoqërive të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, midis klasave politikisht të maturuara dhe të pamaturuara, midis institucioneve demokratike të konsoliduara dhe atyre të paqëndrueshme, nuk qëndron në faktin e ekzistencës së krizave ose jo, por në aftësinë për t'i zgjidhur ato paqësisht përmes bisedimeve, dialogut dhe negociatave, ose nëpërmjet institucioneve.

Në Shqipëri bisedimet, dialogu dhe negociatat janë kulturë e munguar, ose më saktë pjesë e antikulturës sonë. Kjo duket edhe në lojërat e fjalëve që shiten këto ditë si 'dituri' por, në fakt, janë pakuptimshmëri e plotë. Të tilla dëgjojmë si, p. sh., pyetja retorike 'kur do të bisedojmë', ose ftesa e shtirur, 'ejani të bisedojmë'(?), ose pohimi i zbrazët, 'dialogojmë, por nuk negociojmë'(?), ose ultimatumi, 'dorëheqja është e panegociueshme', ose 'zgjedhjet e parakohshme janë të panegociueshme' e të tjera, që nuk i afrojnë palët drejt tryezës së negociatave.

Bisedimet, dialogu, negociatat janë pjesë të një tërësie instrumentesh komunikuese që përdoren në vijueshmëri dhe në të njëjtën kohë dhe hapësirë dhe për qëllime të përafërta ose të njëjta. Bisedimet janë formë e shprehjes së mendimit nëpërmjet fjalëve. Në bisedime palët nëpërmjet shprehjes informohen reciprokisht midis palëve. Në diplomaci bisedimet janë faza e parë dhe njëkohësisht e përhershme e komunikimit të dy ose më shumë palëve. Dialogu është formë e shprehjes së mendimeve nëpërmjet fjalëve në mënyrë alternative dhe shkëmbyese midis dy ose më shumë palëve. Dialogu, krahas bisedimeve, pra informimit reciprok midis palëve, përmban edhe të drejtën e shkëmbimit të mendimeve, pyetjeve e komenteve reciproke. Në diplomaci dialogu është nivel më i lartë se bisedimet.

Ndërsa negociatat përmbajnë diskutime formale midis njerëzve ose grupeve të caktuara, të cilët kanë dallime synimesh dhe qëllimesh, sidomos në biznes dhe në politike, nëpërmjet të cilave palët përpiqen të arrijnë një marrëveshje. Si të tilla negociatat përmbajnë edhe informimin reciprok, edhe dialogun me pyetjet dhe komentet reciproke, edhe alternativat, opsionet dhe mekanizmat e propozuara nga palët, edhe arritjen e zgjidhjes me marrëveshje. Në diplomaci negociatat janë nivel më i lartë se bisedimet dhe dialogu. Pra, me gjithë nuancat dalluese ndërmjet bisedimeve, dialogut dhe negociatave, ato sërish janë vetëm instrumente komunikuese të realizimit të zgjidhjeve paqësore të problemeve, krizave dhe konflikteve.

Drejt negociatave, afër dhe larg

Në rastin konkret kriza politike e Shqipërisë ka kohë që ka nisur. Reagimet në rritje të njerëzve, pakënaqësitë përherë e më të shumta, protestat gjithnjë e më masive, veprimet dhe lëvizjet shoqërore tejet të gjallëruara janë shtrirë në kohë, në hapësirë dhe në shumë shtresa të vendit. Veprimet e kohëve të fundit të opozitës me dorëzimin e mandateve parlamentare shënojnë përshkallëzimin e krizës, përtej së cilës vendi mund të kalojë në mosbindje civile, në kaos dhe në anarki me pasoja serioze në të gjitha fushat.

Ndërkohë palët deri tani kanë biseduar pafundësisht në forma e rrugë të ndryshme, kanë dialoguar midis tyre në parlament, në konferenca shtypi, në debate mediatike. Dallimet e synimeve dhe qëllimeve të tyre tanimë njihen publikisht brenda dhe jashtë vendit. Në këtë fazë të krizës bisedimet dhe dialogu janë thuajse të konsumuara. Ajo që qartazi mungon tani është negociata midis palëve, pra përpjekja e palëve për të afruar diferencat e synimeve dhe qëllimeve të ndryshme dhe të kundërta drejt një marrëveshje të pranuar për zgjidhjen e krizës.

Deri tani të dy palët, mazhoranca dhe opozita vetëm kanë shpalosur synimet dhe qëllimet e ndryshme dhe të kundërta, por asnjëra nuk është shprehur në favor të negociatave. Përse palët i kundërshtojnë negociatat? Dy janë arsyet kryesore: së pari, palët nuk kanë aspak besim te njëra-tjetra. Mungesa e besimit është një nga pengesat kryesore që pamundëson zhvillimin e negociatave, sidomos në politikë. "Confidence first, than negotiation", pra 'besimi i parë, pastaj negociatat". Përse nuk kanë besim? Arsyeja kryesore e mosbesimit qëndron kryesisht te 'marrëveshja e majit 2017', e cila konsiderohet si 'dështim' i opozitës nga mazhoranca dhe si 'kurth pabesia' i mazhorancës nga opozita. Për të dy palët kjo marrëveshje është testi i pabesueshmërisë të deri tanishme. Së dyti, palët nuk ulen në negociata për shkak se kriza akoma nuk ka arritur pikun e saj. Piku i krizës, në kuptimin e vajtjes drejt negociatave do të thotë ardhja e momentit kur palët kanë arritur të përafrojnë forcat e tyre politike, kur asnjëra palë nuk është aq e fuqishme sa të imponohet mbi tjetrën, sikundër as aq e dobët sa të mos konsiderohet. Ky moment piku vjen nëpërmjet zgjerimit dhe thellimit të mëtejshëm të krizës, proces në të cilin pala në pushtet vjen duke u dobësuar, ndërsa pala në opozitë vjen duke u fuqizuar. Kjo po ndodh. Sa do zgjasë, nuk dihet. Çfarë forme do arrijë piku i krizës, gjithashtu nuk e qartë.

Tentativa nga jashtë, dështimi dhe dinamikat

Në këtë tablo krize faktori ndërkombëtar po mban qëndrime të paqarta, të ndryshme e kontradiktore. Kështu mediet Perëndimore po rritin frymën kritike kundrejt mazhorancës dhe po mbështesin kauzën e opozitës. Disa institucione të BE po shpalosen pro mazhorancës dhe kritike me opozitën. Ndërsa ndër qeveritë nacionale të vendeve të BE-së, disa duken më pro opozitës, disa më pro mazhorancës, ndërkohë që disa të tjera mbeten vëzhguese. Në ShBA media është kritike për mazhorancën dhe inkurajuese për opozitën. Nga administrata e ShBA qëndrimet janë dinamike, duke lëvizur nga shumë diplomatike, në më të drejtpërdrejta kritike ndaj mazhorancës.

Kjo tablo kaq diverse dhe dinamike ndërkombëtare në qasjen ndaj krizës shqiptare vjen gjithashtu për katër arsye: së pari, mungesa e informacionit të plotë dhe të argumentuar lokal dhe ndërkombëtar, politiko-diplomatik dhe mediatik rreth krizës. Së dyti, nga mungesa e maturimit të krizës, që nuk ka kulmuar ende sa që të shpalosë qartë shkaqet dhe burimet e saj. Së treti, nga mos përcaktimi i qartë i palëve në synimet dhe qëllimet e tyre si dhe për mjetet që po përdoren dhe do përdoren për arritjen e tyre. Së katërti, nga qasjet relativisht të ndryshme dhe shpesh të kundërta brenda vetë faktorit Perëndimorë dhe hezitimit për tu përfshirë në këtë krizë të brendshme. Së fundi, nga përpjekja për të shuar qoftë edhe me retorikë epitetimin 'Pranvera Ballkanike', e cila do ishte e paparashikueshme dhe tejet e rrezikshme për Ballkanin dhe për vetë Perëndimin.

E para tentativë për të sjellë zgjidhje nga jashtë në krizën Shqiptare ishte nga një delegacion i PE-së që erdhi në fillimet e krizës. Delegacioni PE-së nuk e fshehu dot konfuzionin, mungesën e informimit, paqartësitë për burimet dhe shkaqet e krizës si dhe për synimet dhe qëllimet e opozitës. Delegacioni shfaqi ngurtësi politike, në sjellje, qëndrime dhe në gjuhën e përdorur. Me ngurtësinë politike dhe mangësinë diplomatike delegacioni e thelloi ndarjen midis palëve në krizë, në vend që ta ngushtonte atë. Delegacioni i PE nuk bëri asnjë tentativë për të ndërmjetësuar për zgjidhjen e krizës, por thjeshtë shpalosi një qëndrim politik të parafiksuar.

Ndërmjetësuesit e krizave politike kërkojnë angazhim diplomatik, pra përpjekje për gjetje kompromisi, nëpërmjet bisedimeve, dialogut dhe negociatave. Delegacioni i PE erdhi, foli dhe iku pa lënë pas asnjë impakt pozitiv në zgjidhjen e krizës politike. Delegacioni inkurajoi më shumë seç duhej mazhorancën dhe provokoi më shumë seç duhej opozitën. Pra fuqizoi më të 'fortin' dhe dobësoi më të 'dobëtin'. Ky qëndrim zhbalancoi, në vend që të balanconte palët në krizë si mënyra më e drejtë, më e saktë dhe më e dobishme për të kërkuar dhe gjetur zgjidhjen e negociuar. Me këtë qëndrim delegacioni i PE përkeqësoi më tej klimën politike në vend. Ai thelloi hendekun midis palëve në krizë. Zgjati agoninë e vendit. Konfuzoi palët. Ç'orientoi opinionin publik.

Zgjidhja e mundshme nga faktori i brendshëm politik e institucional

Demokracia është sistem dinamik, në lëvizje, në ndryshim, në zhvillim. Brenda sistemit politik demokratik, ndër të tjera ekzistojnë dy ligje të përhershme: konkurrenca dhe rrotacioni. Këtyre dy ligjeve demokratike nuk i shpëton dot politika. Por, nga vetë natyra e tyre këto dy ligje krijojnë, gjenerojnë e shpërthejnë kriza. Kjo e bën sistemin demokratik kundërshtar të stanjacionit. E bën sistemin demokratik të jetë vetëkorrigjues i vazhdueshëm. E bën sistem më të mirë se të tjerët. Ose, më pak të keq se të tjerët. Bashkëjetesa me krizat e bëjnë sistemin demokratik më të aftë për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e tyre me rrugë dhe mjete paqësore.

Unë mendoj se politika shqiptare në këto 28 vjet ka fituar mjaft përvojë, për keq apo për mirë, dhe ka krijuar mjaftueshëm aftësi, nëpërmjet të cilave lypet të kërkohet dhe të gjendet zgjidhja e krizës aktuale brenda Shqipërisë. Politika shqiptare, përvoja dhe aftësitë e saj është momenti historik të demonstrojnë më së fundi se janë maturuar mjaftueshëm për të menaxhuar dhe zgjidhur krizat vetë.

Ky hap shumë i dëshirueshëm do i shërbente vendit si dhe do arsyetonte plotësisht në sy të BE-së dhe 27 vendeve anëtare të saj se Shqipëria e meriton hapjen e negociatave për anëtarësim, ndër të tjera edhe për aftësinë e treguar për të zgjidhur me mjete paqësore politike dhe diplomatike krizën e saj të brendshme. Në këtë mënyrë, kriza aktuale që deri tani duket problem serioz përballë BE-së dhe vendeve anëtare, për hapjen e negociatave me Shqipërinë, me zgjidhjen së brendshme nga vetë politika shqiptare, do shndërrohej në një vlerë pozitive që do dëshmonte pjekuri të aktorëve dhe faktorëve politikë në vend. BE-ja dhe vendet anëtare të tij nuk do e qortonin politikën shqiptare për krizën, por do e vlerësonin për vullnetin dhe aftësinë e saj për zgjidhjen politike e paqësore. Pra, klasa politike shqiptare do dëshmonte se ka arritur në një nivel Evropian në qasjen ndaj krizave politike dhe adresimit të tyre.

Në këto 28 vjet rrugë tranzitive drejt konsolidimit të demokracisë Shqipëria ka arritur të ndërtojë një sistem kushtetues institucional të plotë. Ky sistem kushtetues dhe institucional i krijuar me shumë mund dhe kosto për qytetarët shqiptar është momenti që të provohet në funksionalitetin e vet për zgjidhjen e krizave politike në vend.

Lidhur me krizën aktuale, mendoj se nuk janë shteruar institucionet kushtetuese, të paanshme dhe mbi palët për zgjidhjen e krizës. Mosangazhimi i politikës shqiptare për gjetjen e zgjidhjes së krizës dhe mos shterimi i gjithë institucioneve kushtetuese të paanshme dhe mbi palët për ndërmjetësim do ishin në vetvete një dështim më i rëndë se edhe vetë kriza.

Në një vend demokratik ku mazhoranca dhe opozita nuk janë në gjendje të kërkojnë dhe të gjejnë zgjidhje të pranueshme midis tyre në interes të vendit dhe të qytetarëve si dhe nuk shfrytëzohen institucionet kushtetuese të paanshme dhe mbi palët për zgjidhjen e krizave demokracia nuk funksionon. Në këtë proces mazhoranca ka peshën kryesore politike, opozita ka peshën kryesore morale, ndërsa institucionet kushtetuese të paanshme dhe mbi palët kanë peshën e tyre shtetërore.

Për opozitën, lidhur me krizën do të thosha që është mirë të mbajë parasysh se kur hyhet në një rreth krize është e nevojshme të ketë edhe një strategji dalje prej saj. Nuk hyhet në krizë me formula të

→

ngurta, me veprime ad-hoc, ose me aksion të improvizuar. Hyrja në krizë pa strategji dalje nga ajo është me pasoja për vendin dhe për vetë opozitën. Strategjia e daljes nga kriza dizajnohet me disa faza, me disa skenarë dhe me disa zgjidhje. Është detyrë e opozitës të jetë e gatshme dhe e qartë në strategjinë e saj ndaj ofertave opsionale të mazhorancës.
Për mazhorancën, lidhur me krizën do të thosha që nevojitet të zbresë me këmbë në tokë, të shohë realitetin në sy, të heq dorë nga qëndrimet skematike, nga retorika propogandistike, nga sjelljet arrogante, nga klishetë mekanike dhe të mendojë jo për margjinalizimin dhe anatemimin e skajshëm të opozitës apo për sajimin e opozitave false, por për tërheqjen dhe përfshirjen e opozitës reale drejt një kompromisi politik. Është detyrë e mazhorancës që të ofrojë zgjidhje alternative, me sjellje tolerante dhe me frymë kompromisi ndaj opozitës.
Lidhur me faktorët kushtetues dhe institucional, konkretisht institucionin e Presidentit të Republikës, do të thosha që nevojitet të angazhohet gradualisht për krizën, duke e ndjekur atë hap pas hapi, me paanësi dhe mbi palët si dhe me deklarime, qëndrime dhe veprime që i shërbejnë rritjes së besimit dhe garancive të tij tek të dy palët e përfshira në krizë. Në kushtet kur mazhoranca dhe opozita qëndrojnë në tabore më vete dhe të ngurta dhe gjendja mund të përkeqësohet lind nevoja që të hyjë në lojë ky faktor i tretë i brendshëm, kushtetues e institucional, konkretisht presidenti i Republikës, i paanshëm dhe mbi palët për të ndërmjetësuar në zgjidhjen e krizës. Specifikisht, presidenti Meta, me përvojën institucionale, peshën politike dhe statusin kushtetues mund dhe duhet ta marrë përsipër këtë rol.
Vetëm në rast dështimi i çdo përpjekje politike të brendshme dhe i shterimit të institucionit kushtetues të paanshëm dhe mbi palët, atëherë mund të lind nevoja për ndërmjetësim ndërkombëtar. Por jo çdo faktor ndërkombëtar mund ta bëjë këtë rol, jo çdo delegacion i huaj ka vullnet për këtë mision, jo çdo i ardhur nga jashtë është i përgatitur për këtë sfidë, jo çdo përfaqësues i huaj ka paanësinë, besueshmërinë dhe kapacitetin për zgjidhjen e krizës. Natyrisht 'dorëzimi' sërish i politikës dhe institucioneve shqiptare në 'duart' e faktorit ndërkombëtar për zgjidhjen e krizës do ishte dështimi i radhës, i cili do na largonte akoma më shumë nga shansi për hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Qosja: I ftoj pushtetarët në Shqipëri e në Kosovë të mësojnë prej shqiptarëve të Tuzit

Prishtinë, 6 mars (ER) - Akademik Rexhep Qosja ua ka uruar shqiptarëve të Komunës së Tuzit fitoren në zgjedhjet që u mbajtën të dielën në këtë komunë. "Shqiptarëve të Komunës së Tuzit, shqiptarëve të Hotit e Grudës, shqiptarëve të Malësisë së Madhe, shqiptarëve të Malit të Zi, gjithë shqiptarëve kudoqofshin ata, ua uroj Fitoren e Madhe: fitoren e shqiptarëve në Komunën e Tuzit në zgjedhjet komunale. Malësia e Madhe kurrë s'ka qenë e madhe me sipërfaqe, por Malësia e Madhe gjithmonë ka qenë, është e do të jetë e Madhe me etikën e saj, me atdhetarizmin e saj, me mendjen e saj, me nderin e saj, me burrërinë e saj e me shumë vlera



të tjera që e kanë bërë të lavdishme në historinë e popullit shqiptar, që e kanë bërë të lavdishme në sytë e gjithë atyre të huajve që gjatë historisë vizituan Malësinë e Madhe", ka shkruar Qosja në llogarinë e vet në "Facebook".
Ai ka thënë se Malësia e Madhe u tregua e madhe me virtytet dhe vlerat e saj edhe kësaj here: "U tregua e madhe me bashkimin e forcave politike të shqiptarëve në Malin e Zi. Bashkimi e siguroi fitoren. Por me këtë bashkim ajo u dha mësim edhe qytetarëve shqiptarë në Shqipëri e në Kosovë. I ftoj pushtetarët në Shqipëri e në Kosovë të mësojnë çka duhet mësuar, prej shqiptarëve të Komunës së Tuzit, prej shqiptarëve të Malësisë së Madhe", ka shkruar ai. "Kryetarit të Komunës së Tuzit, z. Nik Gjeloshaj dhe deputetëve komunalë, u uroj punë të mbarë në veprimtarinë e tyre politike për të mirën e gjithë qytetarëve të Tuzit, gjithë shqiptarëve të Malit të Zi", ka shkruar akademik Rexhep Qosja.

Liridon Aliti, doktor i Nanoshkencës në Kopenhagë të Danimarkës

Kopenhagë, 6 mars - Pasi përfundoi fakultetin dhe masterin në Fakultetin e Shkencave Natyrore-Nanoshkencë në Universitetin e Kopenhagës, 27-vjeçari Liridon Aliti, shqiptar i lindur në Kopenhagë të Danimarkës, nga prindër tetovarë, të mërkurën mbrojti me sukses të shkëlqyer tezën e doktoratës të titulluar "Qasje mikrofluide për aplikimet biologjike duke përdorur nanostrukturat vertikale 3D".
Rezultatet e Liridon Alitit dhe përfundimi i doktoratës në afat rekord janë inkurajuese dhe dëshmi se një numër talentesh shqiptarë kanë arritur të depërtojnë në universitetet më prestigjioze në botë. Puna e Liridonit për të arritur deri në gradën e doktoratës në nanoshkencë duhet të shërbejë si shembull i mirë që duhet të ndjekin shumë

të rinj që janë në shtetet e demokracive perëndimore. Mirëpo, edhe shtetet tona duhet t'i hapin sytë dhe të gjejnë metodat joshëse për tërheqjen e kuadrove të tilla në universitetet shqiptare në Shqipëri, në Kosovë apo në Maqedoni, sepse përfshirja në gjirin e universiteteve tona të kuadrove të përgatitura në universitete të tilla është garanci për përmirësimin e sistemit tonë të arsimit.
Nuk na mbetet gjë tjetër pos ta urojmë Liridon Alitin për këtë rezultat të madh. Të lumtë Liridon dhe dalsh gjithmonë faqebardhë!
Liridon Aliti është djali i Adnan Alitit, veprimtar i shquar i çështjes kombëtare dhe gazetar i Radio Televizionit "Zëri i Kosovës" në Danimarkë.

(Lulëzim Etemaj)



Sot mbahet seancë e jashtëzakonshme për platformën e dialogut

Prishtinë, 6 mars (ER) - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mërkurën, në një mbledhje të përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të drejtuar nga Kadri Veseli, kryetar, ka shqyrtuar kërkesën e kryeministrit për seancë të jashtëzakonshme. Konform kërkesës, Kuvendi vendosi që seanca e jashtëzakonshme të mbahet sot (e enjte), në orën 9:00, me këtë rend dite: 1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë; 2. Shqyrtimi i platformës për dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Ramosaj nënshkruan kontratën me kompaninë 'Lika' për mirëmbajtjen verore të rrugëve

Deçan, 6 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se të mërkurën me kompaninë "Lika" ka nënshkruar kontratën për mirëmbajtjen verore të rrugëve. Kjo kontratë është nënshkruar për periudhën dyvjeçare. Kontrata me kompaninë "Lika" për mirëmbajtjen verore të rrugëve kap vlerën 581,000.00 euro.

Agron Kuçi nderon dëshmorët për 21-vjetorin e 'Epopesë së UÇK-së'

Junik, 6 mars (ER) - Me rastin e 21-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së" dhe rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, së bashku me bashkëpunëtorët, ka bërë homazhe të mërkurën, duke nderuar dëshmorët e kësaj komune. Kryetari Kuçi ka thënë se falë sakrificës së komandantit Adem Jashari, familjes së tij dhe familjes Haradinaj, e dëshmorëve në mbarë Kosovën, sot vendi ynë është i lirë dhe i pavarur.

Malisheva e gatshme ta zbatojë projektin për repelimin e kafshëve

Malishevë, 6 mars (ER) - Zëvendëskryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka pritur të mërkurën në takim ekipin nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të Republikës së Kosovës, në këtë takim informues merrnin pjesë edhe zyrtarë nga Komuna e Rahovecit.

Zëvendëskryetari Berisha i ka njoftuar përfaqësuesit e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me përgatitjet e ekipit lokal i cili do të jetë në gatishmëri të plotë në bashkëpunim me AUV-në dhe kompaninë "Zona-park", e cila e implementon projektin për repelimin e kafshëve në tërë territorin e Komunës së Malishevës. "Koha më e duhur është fillimi i marsit. U bëj thirrje që ta filloni repelimin e kafshëve në javën tjetër të marsit. Përvojat tona që nga viti 2014 kanë treguar efikasitet dhe për fat të mirë që nga ajo kohë nuk kemi pasur viktima nga EHKK-ja, por as të infektuar me këtë virus vdekjeprurës. Si qeveri lokale do të jemi me kapacitete të plota në shërbim të këtij aktiviteti shumë të domosdoshëm që eviton një sëmundje epidemike", ka thënë Berisha.

Ndërsa Sadik Heta, drejtor i Drejtorisë së Shëndetit dhe Mirëqenies pranë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ka theksuar se gjatë vitit 2018 kishin vështirësi në zbatimin e projektit të tillë për shkaqe procedurale. "Këtë vit i kemi bërë të gjitha parapërgatitjet dhe do të fillojmë që nga java tjetër e marsit me repelimin e kafshëve në Komunën e Malishevës, Rahovecit, në disa fshatra dhe në Suharekë", ka thënë ai.

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Malishevës, Murat Hoxha, u ofroi bashkëpunim të plotë dhe profesional për zbatimin e repelimit të kafshëve në të gjitha fshatrat e Malishevës, me gjithë potencialin që ka si drejtori dhe me udhëheqësit e fshatrave. Në fund edhe përfaqësuesi i kompanisë që do ta realizojë projektin trevjeçar, Besnik Hoti, operator ekonomik, ka thënë se janë përgatitur në mënyrë që nga java tjetër ta fillojnë zbatimin e repelimit të kafshëve. Ai ka thënë se produktin që kanë siguruar është me cilësi dhe standarde evropiane.

106 gjoba për ndotësit e mjedisit gjatë muajit shkurt

Prishtinë, 6 mars (ER) - Organizata Let's Do It ka vazhduar monitorimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore nga inspektorët komunalë mjedisorë dhe qendrorë dhe shqiptimin e gjobave për ndotësit. Sipas të dhënave të monitorimit, |rezulton se në të gjitha komunat e Kosovës gjatë muajit shkurt janë shqiptuar gjithsej 106 gjoba. Krahasuar me të dhënat e muajit janar (123), këtë muaj janë shqiptuar 17 gjoba më pak (106), përderisa gjatë muajit dhjetor ishin shqiptuar 84 gjoba, ndërsa gjatë nëntorit ishin shqiptuar 89 gjoba.

Bazuar në monitorimin e Let's Do It Kosova, del se gjatë shkurtit më së shumti gjoba kanë shqiptuar inspektorët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Gjithsej, 47 gjoba për ndotësit e mjedisit. Ndërsa listës së komunave për muajin shkurt iu prin Komuna e Pejës me 24 gjoba të shqiptuara, pasuar nga Komuna e Prizrenit, inspektorët e së cilës kanë shqiptuar gjashtë gjoba gjatë shkurtit. Lista vazhdon me Komunën e Ferizajt, Klinës dhe Deçanit, të cilat kanë shqiptuar nga katër gjoba gjatë shkurtit.

Tri gjoba për ndotësit e mjedisit i ka shqiptuar Komuna e Suharekës, ndërsa nga dy gjoba kanë shqiptuar komunat Vushtrri, Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë dhe Rahovec. Ndërsa nga një gjobë kanë shqiptuar komunat si Shtime, Lipjan, Skenderaj dhe Drenas. Komunat që nuk kanë shqiptuar fare gjoba gjatë muajit shkurt janë: Prishtina, Fushë-Kosova, Obiliqi, Podujeva, Vitia, Kamenica, Kaçaniku, Hani i Elezit, Istogu, Juniku dhe Malisheva.

PANDELI SOTIRI, MËSUESI I PARË I SHKOLLËS SHQIPE

Prof. Dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

Populli shqiptar, i cili e ka çarë rrugën e historisë jo vetëm me shpatë në dorë, traditën patriotike dhe revolucionare e ka ruajtur dhe kultivuar brez pas brezi. Jo vetëm duke luftuar me armë, por edhe duke ruajtur dhe kultivuar brez pas brezi. Jo vetëm duke luftuar me armë, por edhe duke ruajtur, zhvilluar e përhapur gjuhën dhe kulturën shqiptare, populli ynë nuk u asimilua ndër shekuj. Andaj vitet 1878-1897 ishin të mbushura me ngjarje të historisë së popullit shqiptar dhe sollën një varg suksesesh kulturore arsimore. Në rrethanat e komplikuara politike dhe kulturore që ndodhej atdheu ynë, kur synohej për t'u shkombëtarizuar me lloj-lloj shkollash e kulturash, përpjekjet e atdhetarëve së Rilindjes për gjuhën, shkollën dhe alfabetin shqip dolën në plan të parë, duke i shërbyer ngritjes së ndërgjegjes kombëtare dhe bashkimit të popullit në përgjithësi.

Në verë të vitit 1885 shoqëria "Drita" - e Bukureshtit dërgoi në Korçë patriotin korçar Thimi Markon me mision që si hap të parë të t'i parashtronte Mitropolisë së Korçës të mësohej gjuha shqipe. Kërkesa natyrisht, u pranua. Po në atë vit patriotët e Korçës, në bashkëpunim të ngushtë me shoqëritë shqiptare të Bukureshtit dhe të Stambollit, iu rrekën punës për të hapur shkollën shqipe. Themelimi i Mësonjëtores shqipe për djem e vasha në Korçë, e çelur në Korçë më 7 mars 1887, ishte një kurorëzim i përpjekjeve të përbashkëta të organizatave patriotike të të mërguarve të Korçës. Që në fillim u tregua nevoja për sigurimin e ndërtesës për mbajtjen e mësimit, mësuesit të cilët duhej të angazhoheshin në këtë shkollë, e sidomos ishte shumë e rëndësishme leja për hapjen e shkollës shqipe. Leja për një shkollë private shqipe u desh të nxirrej në Ministrinë e Arsimit të Perandorisë Turke, që u sigurua në emër të Pandeli Sotirit. Shkolla u vendos në shtëpinë private që e fali veprimtari e atdhetari i dalluar i Shoqërisë "Drita" të Bukureshtit, Diamand Tërpo. Me ndihmën dhe ndërmjetësimin e vetë vëllezërve Frashëri, mësues i parë dhe drejtor i shkollës së parë shqipe u caktua Pandeli Sotiri.

Pandeli Sotiri jetoi e veproi në një kohë kulmore të Rilindjes sonë Kombëtare, në dy-tri dekadat e fundit të shekullit të kaluar si intelektual i shkallës së lartë, që të gjithë dijet e mundësitë e tij vuri në shërbim të shoqërisë shqiptare, çlirimit kombëtar e të emancipimit shpirtëror. Ky patriot i madh, me angazhimin e tij në shkollën shqipe, la punët e tij e me entuziazëm të paparë largohet nga Stambolli për në Korçë, duke sjellë me vete bagazhin më të pasur për popullin shqiptar me më se 150 abetare. Kjo shkollë e shumëpritur shqipe kishte karakter laik dhe kryesisht mbahej nga patriotët shqiptarë si një pohim i heshtur i njohjes së kombit shqiptar, të cilët ligjet e shtetit turk e mohonin kryekëput, duke i konsideruar turq të gjithë shqiptarët muhamedanë. Mësonjëtorja fillimisht ishte një shkollë autonome që nuk varej, nuk mbahej e nuk mbrohej prej ndonjë shteti a shoqërie të huaj. Kjo shkollë kryesisht ishte ku shqipja qëndronte zonjë në vend të vet e jo shërbëtore e ndonjë gjuhe të huaj - thuhej në shtypin e kohës.

Si mësues i parë i kësaj shkolle Pandelit iu caktuan të ardhura mujore 10 lira turke, ku në të hynin qiraja e shtëpisë dhe, siç shkruan Nuçi Naçi, në rrogë qenë vënë edhe ndihmësi i tij Thanas Sina dhe shërbëtori. Ndërsa nxënësve të varfër pa dallim feje iu falnin libra, fletore, pena e nganjëherë edhe këpucë. Për këtë praktikë demokratike më së miri flet deklarata e nxënëses së parë të kësaj shkolle, Polikseni Luarasi, dhënë në librin "Kujtime veteranësh", më 1962, në Tiranë, e cila në mes të tjerave shkruan: unë jam nxënësja e parë e shkollës shqipe të djemve në Korçë. Unë munda të vazhdoja mësimet në shkollën shqipe, pasi atje nuk paguanim taksë si në shkollat e tjera dhe librat e fletoret na i jepnin darovishte /falas/. Ndërsa, për shëmbëlltyrën e mësuesit vazhdon: "Mësuese të parë mbaj mend Pandeli Sotirin. Ishte i çalë, po shumë i zgjuar, i mësuar dhe patriot i vendosur. Vani Cico Kosturi na thoshte se Pandeli Sotiri ka qenë mik me shkrimtarët patriotë të Rilindjes, me Naim Frashërin, Sami Frashërin. Jani Vreton dhe me idetë e frymën e këtyre përpiqej ta mbronte e ta organizonte shkollën dhe patriotët e Korçës. Ai na vinte shpesh në shtëpi dhe mua më deshe shumë. Jemi nga një vend, më thoshte - nga Gjirokastra me vulë". Ndërsa në mënyrën më emocionale e përshkruan takimin e parë nxënësi Thanas Viso Mborja: "Pandeli Sotiri na priti me buzëqeshje, na përkëdheli kokën e na tha të bëheshim çuna të mbarë e nxënës të mirë", përfundon ky ish-nxënës i mësuesit të parë. U kujtohet shumë nxënësve e prindërve se dita e parë në këtë shkollë të parë shqipe ishte shndërruar në një festë të vërtetë popullore për tërë qytetin. Në këtë ngjarje të rëndësishme jo vetëm për Korçën, por për mbarë vendin, mbajti një fjalim mësuesi dhe drejtori i shkollës, Pandeli Sotiri, i cili me atë buzëqeshjen e tij të qetë e karakterizoi gjatë gjithë kohës me të vegjlit e të rriturit, foli në mënyrë të veçantë për interesimin e tyre dhe rëndësinë kombëtare të kësaj shkolle.

Mësonjëtorja shqipe e Korçës qe shkollë e përbashkët me myslimanë e ortodoksë dhe nuk varej as nga kisha e as nga xhamia. Duke qenë shkollë e përbashkët, për fëmijë besimesh të ndryshme, ajo realizonte edhe një pikë tjetër themelore të programit të Rilindjes Kombëtare për zgjimin dhe rritjen e ndërgjegjes kombëtare, për vëllazërimin dhe bashkimin e popullit. Ishte ky pohim i atëhershëm e që qëndron edhe sot.

Është meritë e Pandelit që u bë mësues dhe drejtor i parë i asaj shkolle që mishëronte aq bukur idealet e rilindësve shqiptarë, sepse e tërë kjo punë ishte një kurorëzim i përpjekjeve të përbashkëta të shoqërive atdhetare të mërgimit e të arsimdashësve në qytet e fshat. Kjo shkollë filloi realizimin e programeve të organizatave atdhetare të brendshme e të jashtme për ruajtjen e kultivimin e gjuhës shqipe si element jetik i vetë kombit.

Duke e nderuar veprën dhe punën e Pandeli Sotirit, në Ditën e Mësuesit, vijmë në përfundim se koha nuk ka mundur ta zbehë veprën e tij, karakterin kombëtar dhe rëndësinë që ka për gjeneratat e ardhshme. I admirojmë të gjithë ata si Pandeli Sotiri për largpamësinë që kanë pasur, e menduar se me fisnikëri e burrëri iu kanë rrekur problemeve në dobi të atdheut e të popullit. Sa të mëdha e të pastra i kanë pasur, i kanë ruajtur e i kanë çuar përpara idealet e tyre atdhetare, për popullin dhe kombin shqiptar këta martirë të shkollës shqipe. Prandaj, me respekt te thellë ne do të qëndrojmë para veprës madhore të tij dhe të të gjitha figurave të shquara të rëna për liri, pavarësi, demokraci dhe për zhvillimin e përparimin e kombit shqiptarë, përkatësisht me rastin e Ditës se Mësuesit do t'i përkujtojmë gjithmonë.

E rrallë

Makina luksoze braktiset në kanal, ja arsyeja

Një makinë luksoze është braktisur në një kanal pasi shoferi humbi kontrollin dhe e nxori nga rruga. Lamborghini që kushton 270 mijë paund u fotografua në Enfield në Londër, pranë fushës së trajnimit të Tottenham Hotspurit. Automjeti është në pronësi të Michael Hudsonit, pronar i firmës "Bitscocks".

FOTO E DITES

Disa persona nga Venezuela shihen duke kaluar ilegalisht kufirin në Kolumbi. /AP/

E jashtëzakonshme

Gjendet kafka e vjedhur e mumies 800-vjeçare

Kafka e një mumie 800-vjeçare që u grabit nga një dhomë e nëndheshme në një kishë në Dublin është gjetur. Trupi i mumies, e njohur si The Crusader, u dërrmua nga hajdutët dhe koka e saj u grabit. Ngjarja ndodhi në kishën eSaint Michannë fund të muajit shkurt. Një udhërrëfyes zbuloi se koka ishte zhdukur pasi shkoi për ta hapur kishën për turistët. Vendvarrimi i lashtë ku mbahej trupi gjithashtu u dëmtua rëndë.

BARSOLETA E DITËS

- Vëlla, a ma jep veturën sonte?
- Vëlla, a beson se baxhanaku ma lypi më herët e ia dhashë.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI Ditë e qetë pa asnjë detyrim për të respektuar. Sot jeni më të orientuar tek reflektimet sesa tek veprimet konkrete.

DEMI Duke qenë se sot keni të gjithë planetët në shenjen tuaj dita do të jetë e shënjuar nga një ndjenjë e fortë optimizmi.

BINJAKËT Në fushën e ndjenjave keni mjaft momente kur nuk do të kuptoni se kush është drejtimi që po merr lidhja juaj. Iniciativat që keni marrë do të dështojnë.

GAFORRJA Midis kolegëve sot do të ketë një bashkëpunim të përsosur për të realizuar një projekt me afate mjaft të ngushta kohore.

LUANI Gjatë ditës rutina juaj është puna ose aktivitetet e biznesit, ndërsa në mbrëmje do të organizoni një darkë familjare që kishit kohë që e mendonit.

VIRGJËRESHA Dashuria dhe marrëdhëniet me të tjerët janë kryefjala e ditës së sotme. Në çdo moment do të përkujdeseni për njeriun e zemrës.

PESHORJA Ndjenja e përgjegjësisë ju bën të jeni mjaft të përkushtuar me personat rreth jush. Fëmijët sot do të jenë mjaft të përkëdhelur në shoqërinë tuaj.

AKREPI Një ditë mjaft e bukur si për shoqërinë, po ashtu edhe për dashurinë. Ju jeni të kudondodhur dhe ndihmoni këdo me optimizmin tuaj.



SHIGJETARI Zakonisht nuk jeni shumë të përqendruar te gjërat që bëni. Por, sot do t'ju duhet të mos neglizhoni asnjë detaj në një punë të dhënë.

BRICJAPI Nuk shquheni për tip social, por sot rizgjimi i natyrës si dhe aktivitetet artistike do të bëjnë që të doni vetëm të lëvizni.



UJORI Sot çuditërisht jeni bërë materialist, mbase shkaku i financave të pakta kohët e fundit. Do të llogarisni çdo shpenzim që do të bëni.

PESHQIT Jeni aq dembel sot sa të ishte në dorën tuaj ta kalonit gjithë ditën shtrirë në divan. Por, nuk keni çfarë të bëni, se keni detyrime kontraktuale.



Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	RENNES - ARSENAL	2	CHELSEA - DYNAMO	1-1	SEVILLA - SLAVIA	1-1

Prishtina dhe Feronikeli ndahet në 'paqe'

Derbi në i zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në mes Prishtinë dhe Feronikelit përfundoi pa ftues (1-1), kurse barazim më se miri e ka shfrytëzuar Llapi që ka barazuar pikët me Prishtinën dhe është vetëm pesë pikë larg Feronikelit që zë vendin e parë

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 6 MARS - Pesë pikë vazhdon të jetë diferenca e pikëve në mes Feronikelit dhe Prishtinës edhe pas derbit të javës së 21-të, në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi ndeshja e zhvilluar mes këtyre dy skuadrave në stadiumin "Fadil Vokrri" përfundoi 1-1. Trajneri i Prishtinës, Mirel Josa është ndarë i pakënaqur me barazimin ndaj Feronikelit, pasi beson se skuadra e tij e ka merituar fitoren. "Nuk jam i kënaqur me barazim, por duke parë episodet që solli ndeshja, jam i kënaqur për mënyrën sesi skuadra vrapoi dhe luajti. Jam i kënaqur në përgjithësi me lojën, por jo me rezultatin. Ashtu siç morëm ne karton te kuq, mund të merrte edhe Feronikeli te rasti i Ergyn Ahmetit, pasi portieri ishte komplet jashtë portës. Mendoj se këtu u veprua me dy standarde, jo më qëllim po gabimisht. Megjithatë lufta vazhdon deri në fund", ka thënë Josa. Feronikeli rrezikoi e para në minutën e 14-të, por gjuajtja e Kastriot Rexhës më kokë përfundoi jashtë portës se Bekajt. Tre minuta më vonë, Prishtina e dënoi skuadrën mysafire nga Drenasi, pasi Leotrim Bekteshi më kokë shënoi për 1-0, pas një ndërprerje. Në pjesën e parë të dyja skuadrat rrezikuan nga një herë fillimisht "Nikli" me anë të Rexhës e me pas Prishtina nëpërmjet Boshnjakut. Pjesa e dytë nisi më mirë për vendasit, por Rexha nuk e shfrytëzoi një pasim të Silvas dhe rezultati mbeti i pandryshuar. Në minutën e 57-të, Lorik Boshnjaku përjashtohet nga loja pas kartonit të dytë të verdhë. Mysafirët e shfrytëzuan këtë epërsi dhe arritën të barazojnë rezultatin në minutën e 64-të, autor i golit ishte Mendrurim Hoti. Prishtina edhe pse pa një lojtarë në minutat në vazhdim rrezikoi edhe tri herë të tjera nëpërmjet Thaqit nga gjuajtja e lirë, Mankendas dhe Ahmetit, por pa sukses. Në anën tjetër Feronikeli e pati edhe një rast të mirë shënimi, por gjuajtjen e Artur Maganit e ndali portieri Bekaj. Feronikeli vazhdon të ketë pesë pikë më tepër se Prishtina në krye të tabelës me 49 pikë, kurse kryeqytetasit kanë grumbulluar 44 pikë. Trajneri i Feronikelit, Zekrija Ramadani pas ndeshjes deklaroi: "Morëm atë për çka erdhëm. Duke parë rrjedhën e lojës kishim mundësi të fitonim. Kërkonim golin e dytë me ngulm, bëmë zëvendësimet, por nuk erdhi goli i fitores. Edhe Prishtina na rrezikoi me një lojtarë më pak dhe u mbrojt mirë pa një lojtarë".

Llapi nuk gabon ndaj Gjilanit, fitojnë Ferizaj dhe Liria

Llapi ka shënuar fitore të rëndësishme në ndeshjen ndaj Gjilanit me rezultat 1-0. Për tri pikë mysafirëve u përkujdes Elvis Prençi, i cili realizoi në minutat e fundit të ndeshjes. Ndërkohë, pikë të mëdha ka arkëtuar edhe Liria në luftën për mbijetesë, duke e mposhtur Trepçën'89, në Mitrovicë, me rezultat 2-1. Golat në këtë ndeshje i shënuan Fetahaj e Mustafa për Lirinë, ndërkohë për Trepçën 89 shënoi Gava. Ndërkohë, tri pikë si vendase i arkëtoi Ferizaj, që e mposhti KEK-un, me rezultat 4-1. Shabani shënoi 2 herë, derisa me nga një gol kontribuuan Gashi e Demiri, derisa golin e vetëm për KEK-un e shënoi Hajdini. Ndeshja e vetme që u mbyll pa fitues ishte ajo në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj, ku Drenica dhe Flamurtari u ndanë baras 1-1. Golat në ndeshje u shënuan nga Nicholas Andreës për vendasit dhe Egzon Krasniqi për mysafirët.

IPKO SUPERLIGA

Ballkani - Drita	1-2
Trepça '89 - Liria	1-2
Drenica - Flamurtari	1-1
Gjilani - Llapi	0-1
Ferizaj - KEK-u	4-1
Prishtina - Feronikeli	1-1

Tabela

		PIKË
1. Feronikeli	21	49
2. Prishtina	21	44
3. Llapi	21	44
4. Drita	21	32
5. Gjilani	21	29
6. Drenica	21	28
7. Trepça '89	21	28
8. Flamurtari	21	27
9. Ballkani	21	27
10. Ferizaj	21	24
11. Liria	21	23
12. KEK-u	21	1

Në Kosovë do të formohet Federata e Ragbit

PRISHTINË, 6 MARS - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të mërkurën në takim, në kabinetin e vet, ambasadorin britanik në Kosovë, Ruairi O'Connell. Gjatë këtij takimi është biseduar rreth bashkëpunimit të deritashëm, por edhe për gatishmërinë për ta vazhduar këtë bashkëpunim dhe për të zhvilluar projekte konkrete. Veçanërisht u diskutua për hapjen e Federatës së Ragbit në Kosovë. "Jemi të gatshëm të vazhdojmë të punojmë bashkërisht për realizimin e projekteve të përbashkëta sepse vetëm kështu mund të arrijmë të kemi suksese dhe t'i plotësojmë nevojat e të rinjve tanë e, pse jo, t'i shkëmbejmë edhe përvojat tona dhe profesionistë të ndryshëm. Po ashtu, jemi të gatshëm për ta jetësuar idenë e formimit të Federatës së Ragbit në Kosovë dhe do të angazhohemi maksimalisht në këtë drejtim që ta japim kontributin tonë për zhvillimin e këtij sporti me pak traditë në vendin tonë", ka thënë ministri Gashi. Në anën tjetër, ambasadori O'Connell falënderoi ministrin Gashi për pritjen e tij dhe për gatishmërinë e tij në lidhje me krijimin e Federatës së Ragbit në Kosovë. Ambasadori britanik u shpreh se është i kënaqur për këtë angazhim të ministrit dhe të MKRS-së që t'u jepet hapësirë sporteve të reja në Kosovë.

Sonte zhvillohen ndeshjet në Ligën e Evropës

Londër, 6 mars - Pas ndeshjeve të Ligës së Kampionëve, sonte (e enjte) zhvillohen ndeshjet në Ligën e Evropës. Chelsea, që është një prej favoriteve në këtë garë, e pret skuadrën e Dynamo Kyivit në ndeshjen e parë, me synim që të shënojë fitore dhe t'i ofrohet kualifikimit. Ndërsa skuadra tjetër angleze, Arsenal, u shkon si favorit francezëve të Rennesit. Napoli e pret Salzburgun, kurse Interi ka punë me Frankfurtin. Ndeshje interesante pritet të jetë edhe ajo në mes të Zenitit dhe Villarrealit. Nga ora 18:55 do të takohen: Dinamo Zagreb-Benfica, Eintracht Frankfurt-Inter, Rennes-Arsenal, Sevilla-Slavia Prague, Zenit-Villarreal. Ndërsa nga ora 21:00 do të takohen: Chelsea-Dynamo Kyiv, Napoli-Salzburg, Valencia-Krasnodar.

Gashi, i pari në renditjen botërore të WKF-së

PRISHTINË, 6 MARS - Karateisti i ri, Melos Gashi, ka shënuar ngritje të madhe në renditjen më të re të Federatës Ndërkombëtare të Karatesë (WKF). Gashi ndodhet i pari në renditjen e kadetëve, kategoria plus 70 kilogramë. Ky sukses i Melosit vjen pas shpalljes nënkampion i Evropës, në Kampionatin Evropian të mbajtur muajin e kaluar në Aalborg të Danimarkës. Melosi ka grumbulluar 1 065 pikë në total, 30 më shumë se i dyti, Maros Janovcik (Slovaki). "Shpresojmë që me këtë paraqitje në kohën e fundit do ta arrijmë edhe titullin e më të mirit të botës", thuhet në njoftimin e Federatës së Karatesë së Kosovës. Medaljen e bronztë në evropian e kishte fituar edhe Albulena Gërvalla në grupmoshën U-21. Ajo në renditjen e re të WKF-së ndodhet e 16-ta me 510 pikë të tubuara.

Xhaka: Do të jetë një hap i madh nëse kthehemi në Ligën e Kampionëve

LONDËR, 6 MARS - Mesfushori shqiptar Granit Xhaka beson se kthimi i Arsenalit në Ligën e Kampionëve do të ishte një hap i madh për skuadrën pas largimit të ish-trajnerit Arsene Wenger dhe emërimit të Unai Emerys. Wengeri u largua nga pozita e trajnerit të Arsenalit në fund të sezonit të kaluar, pas 22 vjetëve me "Topçinjtë". Ai u zëvendësua nga Emery, i cili është në proces për ta rindërtuar skuadrën në "Emirates". Përkundër pritshmërisë, Arsenali është në garë për ta zënë një vend në top katërshe të Premierligës, që do ta kualifikonte për sezonin e ardhshëm të Ligës së Kampionëve. Ata janë për momentin në vend të pestë, një pikë larg Manchester Unitedit. Xhaka, i cili luajti 90 minuta në barazimin e së shtunës, kundër rivalit të qytetit, Tottenhamit, beson se kthimi në Ligën e Kampionëve do ta dëshmonte se sa është përmirësuar Arsenali këtë sezon. "Pas largimit të Arsene Wengerit, shumë gjëra kanë ndryshuar në klub. Ne jemi të lumtur me trajnerin dhe jemi përmirësuar shumë. Po punojmë shumë. Do të jetë një hap i madh nëse kthehemi në Ligën e Kampionëve. E duam këtë gjë. Dy herë brenda tri sezoneve të fundit nuk kemi luajtur në Ligën e Kampionëve dhe një klub si Arsenali duhet të jetë pjesë e kësaj gare. Duhet ta dëshmojnë këtë gjë edhe në fushë", ka thënë Xhaka. "I kemi ende nëntë ndeshje dhe jemi afër [me Manchester Unitedin]. Edhe java e ardhshme është shumë e rëndësishme. Ndeshje e madhe. Në shtëpi ne duhet t'i marrim tri pikë. Ajo që e pashë kundër Tottenhamit, shpirti i ekipit, jam shumë i lumtur dhe mendoj se nëse do të jemi kështu deri në fund të sezonit, do t'ia arrijmë qëllimit. Nuk ka të bëjë me mënyrën se si luajmë. Tani të gjithë kemi filluar të besojmë. Kjo është shumë e rëndësishme për skuadrën, për shpirtin. Çdo ditë në stërvitje, ne jemi afër dhe kjo ka shumë rëndësi për ne. Është e rëndësishme për ne dhe trajneri ynë e di që ne duhet ta marrin njërën ndër katër vendet e para sepse qëllimi është të bëhemi pjesë e Ligës së Kampionëve", ka deklaruar Xhaka.

Golden State turpërohet nga Bostoni, humbasin edhe Oklahoma dhe Toronto

OAKLAND, 6 MARS - Bostoni ka korrur një fitore të thellë në fushën e kampionëve të Golden States me rezultatin 128-95, humbja e parë sezonale me më shumë se 30 pikë për ekipin kampion. Edhe pse Warrirosi luante në shtëpinë e vet, me të gjithë titullarët në dispozicion, vendësit bënë një ndeshje të dobët (Curry me 23 pikë shënuesi më i mirë). Një mbrëmje magjike për Bostonin, ku u dallua Haywardi, i cili realizoi 30 pikë, sukses që vendos skuadrën e Celticsit mes pretendentëve për titull. Jashtë fushës fiton edhe Houstoni, që mundi 107-85 Toronton, ndeshje e dominuar nga teksanët, që po kalojnë një moment të mirë në NBA.

Leonard realizoi 26 pikë për kanadezët, por që mbetën për statistikë, ndërsa për Houstonin u dallua i zakonshmi Harden, autor i 35 pikëve. Fiton edhe Philadelphia, që mundi 114-106 Orlandon, një sukses i merituar i ekipit vendës, ku të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë (Reddick më i miri me 26 pikë). Zhgënjen skuadra e Oklahomës, që u mund 131-120 nga Minnesota, sfidë e dominuar nga basketbollistët vendës, me Townsin që realizoi 41 pikë e 14 rebounde, liderë në parket. Për Oklahomën u dalluan Westbrooku (38 pikë e 13 rebounde) e George (25 pikë), por të pambështetur sa duhet nga skuadra. Indiana, falë 27 pikëve të Bogdanoviçit, mundi 105-96 Chicagon, ndërsa Memphisi triumfoi 120-111 ndaj Portlandit, ndeshje ku u dallua Conley me 40 pikë.

REZULTATET

Indiana - Chicago	105-96
Philadelphia - Orlando	114-106
Memphis - Portland	120-111
Minnesota - Oklahoma	131-120
Toronto - Houston	85-107
Golden State - Boston	95-128

SHKURT

Gavazaj, afër Dinamo Minskit

Futbollisti nga Kosova, Enis Gavazaj, mund të transferohet në Bjellorusi. Sulmuesi i Skënderbeut është duke zhvilluar një provë te skuadra bjelloruse e Dinamo Minskit. Kjo e fundit aktualisht po zhvillon fazën përgatitore në Turqi dhe Gavazaj u aktivizua titullar dy ditë më parë në një ndeshje miqësore. 23-vjeçari nga Prizreni prishi kontratën e huazimit me rusët e Yenisey vetëm disa javë më parë dhe tashmë është në kërkim të një klubi të ri për ta vazhduar karrierën.

Solari nuk jep dorëheqje

Santiago Solari nuk planifikon të japë dorëheqje nga pozita e trajnerit të Real Madridit, ani pse kjo skuadër është eliminuar nga Liga e Kampionëve. "Nuk kam ardhur këtu për t'u dorëzuar", ka thënë Solari në konferencën për shtyp pas përballjes kundër Ajaksit të cilët u kualifikuan në çerekfinale me rezultat të përgjithshëm 5-3.

Ten Hag: Kështu e eliminuam Realin

